



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
SPORT MARKETING PRISHTINË

SHPALL:

T E N D E R P Ë R :
SHERBIMET HOTELIERE NË PISHINËN E GËRMISË NË
PRISHTINË

Në bazë të Statutit të NPL "Sport Marketing" sh.a. dhe programit të punës për sezonin veror të vitit 2021, për menaxhimin e Pishinës në Gërmi, NPL "Sport Marketing" shpall tender publik për shërbime hoteliere të cilësisë së lartë në lokacionin e pishinës për sezonin veror 2021.

Historiku:

NPL "Sport Marketing" sh.a. Prishtinë ka në menaxhim Pishinën në Gërmi. Në MTI është e regjistruar si NPL "Sport Marketing" sh.a Çertifikata nr. 810454497 dt. 17.10.2000.

1. Kërkojmë partner biznesi për sigurimin e shërbimeve hoteliere gjatë **Sezonit Veror 2021**. Shërbimet duhet të jenë të kualitetit të lartë, sipas standardeve evropiane. Çmimet duhet të jenë të pranueshme për rininë shkollore, universitare dhe për të gjithë vizitorët që vijnë në pishinën e Gërmisë. Ushqimi që duhet të propozohet: hamburger, ushqim nga skara, mish pule, pica dhe të tjera, akullore, pije freskuese dhe pije joalkoholike.

2. NPL "Sport Marketing" sh.a. ofron lokacionin e pishinës në Gërmi, si dhe kyçjen në rrjetin elektrik dhe atë të ujit.

Por, hapësira e amfiteatrit të pishinës dhe fushat sportive të tenisit i mbesin në dispozicion NPL "Sport Marketing" sh.a , mirëpo për të organizuar manifestime sportive dhe mbrëmje kulturo-artistike me marrëveshje herë herë mundet me e shfrytëzue edhe fituesi i tenderit (d.m.th.me aneks kontrate).

3. Ofertat duhet të përfshijnë:

- shumën e propozuar për shfrytëzimin e lokacionit gjatë sezonës 2021, çmimi fillestar është prej **20.000.00€**
- Pagesa e mjeteve duhet të bëhet menjëherë pas lidhjes së kontratës në afat prej 2 (dy) ditësh.
 - Përshkrimin e ushqimit të propozuar dhe pijeve freskuese (me sasi dhe çmim)
 - Përshkrimin e instalimeve për shitje, me plan të detajizuar,
 - Planifikimi i numrit të punonjësve,
 - Përshkrimin e sistemit higjenik dhe sistemit për pastrim.
 - Për të marrë pjesë në tender duhet deponuar mjete në vlerë prej 100€ në llogarin e NPL "Sport Marketing", në bankën BPB me nr. të xhirlogarisë 1300-2712-001184.61. Pas zgjedhjes të tenderit vlera 100€ do t'i mbetet Kompanisë.

4. Afati i dërgesës së ofertave është prej **05.05.2021 – 19.05.2021**.

5. Ofertat e mbyllura në pliko duhet të dërgohen në zyrën kryesore të "Sportmarketingut" në Prishtinë, më së largu deri më 19.05.2021 deri në ora 12:00^h ato të cilat arrijnë pas kësaj date do të refuzohen.

6. Hapja e ofertave do të jetë publike në prezencë të përfaqësuesëve të kompanive me 19.05.2021 në ora 13:00^h në adresën e poshtë shënuar. Tenderin do ta fitoj Kompania e cila ofron kushte më cilësore dhe çmimin më të lartë se çmimi fillestar.

Pishina mund të vizitohet prej 06.05.2021 - 18.05.2021, çdo ditë nga ora 10:00 deri 15:00.

NPL "SPORT MARKETING" sh.a
Rr. Sylejman Vokshi 5/a PRISHTINË

Numri i tel. kontaktues:

+38338704779

e-maili: kpk_sportmarketing@yahoo.com